

06.07.2023  
Ora 17:15

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për miratimin e disa afateve proceduriale që lidhen me përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, që do të zhvillohen më datë 23 Korrik 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- |            |           |              |
|------------|-----------|--------------|
| • Ilirjana | NANO      | Kryetar      |
| • Arens    | ÇELA      | Anëtar       |
| • Dritan   | ÇAKA      | Anëtar       |
| • Helga    | VUKAJ     | Anëtar       |
| • Muharrem | ÇAKAJ     | Anëtar       |
| • Stafi    | KQZ       | Y. Merkaj    |
| Parti      | Politike: | S’ka prezent |

**OJQ:** KRIIK

**Znj. I. Nano:** Përhëndetje, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Mbledhja e sotme e Rregullatorit është thirrur me kërkesë të Komisionerit, i cili e ka vënë në lëvizje Komisionin Rregullator duke propozuar për shqyrtim dhe miratim dy projektaktet të cilat lidhen me përsëritjen e zgjedhjeve në Bashkinë e Rrogozhinës. Zgjedhje që do të zhvillohen

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.06.07.2023*

në datën 23 korrik 2023. Projektvendimi i parë është për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me përsëritjen e zgjedhjeve për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë që do të zhvillohen më datë 23 korrik 2023. Afate të cilat janë propozuar duke patur parasysh që Kodi Zgjedhor nuk ka afate të përcaktuara lidhur me zgjedhjet e pjesshme, zgjedhjet e parakohshme. apo në rastet e përsëritjes së zgjedhjeve. Një procedurë e tillë është ndjekur nga ana jonë edhe në zgjedhjet e pjesshme për 6 kryetarë bashkie, të datës 06 Mars 2022. Projektvendimi tjetër lidhet me një ndryshim në vendimin numër 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores, për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të ndryshuar”. Ndryshim i cili gjithashtu lidhet me një afat ankimimi, nisur nga kushtet e krijuara kur kemi një palë zgjedhje që zhvillohen në një kohë më të shkurtër se sa ato që parashikohen në Kodin Zgjedhor. Për më tepër lidhur me aktet do t’i drejtohesha Sekretarit të Përgjithshëm për të bërë një paraqitje të shkurtër të projektaktit të parë, afatet procedurale dhe të relacionit, zoti Merkaj!

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Neni 20, pika 1, shkronja “a”, Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së, ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore si dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje. Në zbatim të detyrimeve të Kodit Zgjedhor, në këtë projektvendim parashikohen të gjitha afatet procedurale të cilat janë të reduktuara në kohë dhe respektojnë kronologjinë e veprimeve të cilat parashikohen nga Kodi Zgjedhor, siç janë: kohëzgjatja e fushatës zgjedhore, detyrimi për raportim i të gjithë institucioneve për veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë, monitorimi i OSHMA-ve nga Autoriteti i

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.06.07.2023*

Mediave Audiovizive, përcaktimi i afatit për subjektet zgjedhore për paraqitjen e propozimeve për anëtarë të KQV dhe GNV, afati për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore si dhe organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore. Në këtë projektvendim është parashikuar që fushata zgjedhore për zgjedhjet për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, të fillojë më datë 10 korrik deri në datën e zgjedhjeve. Më datë 10 korrik 2023 është parashikuar edhe detyrimi i Bashkisë Rrogozhinë, për të raportuar në KQZ, të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë nga kjo bashki. Kandidaturat për anëtarë në KQV duhet të paraqiten nga partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në KZAZ-në përkatëse, jo më vonë së data 13 korrik 2023. KZAZ-ja merr vendim për emërimin e anëtarëve të KQV-ve brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga data e dorëzimit të propozimeve. Propozimet për anëtarë në GNV do të bëhen jo më vonë së data 17 korrik 2023. KZAZ-ja merr vendim për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga data e dorëzimit të propozimeve. Kërkesa për akreditimin e vëzhguesve shqiptarë dhe për vëzhguesit e huaj paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se data 17 korrik 2023 dhe akreditimi do të bëhet jo më vonë se data 21 korrik 2023. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë tre ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve. Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, duhet të përcaktojë vendet publike në territorin e bashkisë për afishimin nga subjektet zgjedhore të materialeve propagandistike jo më vonë se data 10 korrik 2023. Për sa më sipër, i paraqitet Komisionit Rregullator projektvendimi për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Merkaj, atëherë fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, kolegë fillimisht e diskutojmë në parim. Kemi diçka në parim lidhur me projektaktin e propozuar? Jo!? Kalojmë në miratimin në parim.

**Kush është dakord?**

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.06.07.2023*

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

**Me 5 vota pro, miratohet!**

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen apo pikë për pikë janë 11 të tilla, atëherë Komisioni Rregullator vendosi:

Pika 1. Fushata zgjedhore për zgjedhjet për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë fillon në datë 10 korrik 2023.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

**Me 5 vota pro, miratohet!**

Pika 2. Bashkia Rrogozhinë dhe institucionet e saj të varësisë janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtarit me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 10 korrik 2023, deri ditën e zgjedhjeve. Të njejtin detyrim kanë edhe institucionet publike qendrore, organet e tyre të varësisë dhe degët e tyre vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore për veprimtari me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 10 korrik 2023 deri në ditën e zgjedhjeve, në territorin e Bashkisë Rrogozhinë ose për të. Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 ditë para afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

Për pikën 2, kolegë ka diçka? Kalojmë në votimin e pikës 2.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)


**Kundër:** S'ka

**Me 5 vota pro, miratohet!**

Pika 3. Autoriteti i mediave audiovizive monitoron OSHMA-të për veprimtaritë me karakter publik të institucioneve publike të përcaktuara në pikën 2 të këtij

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.06.07.2023*

vendimi, nga data 10 korrik 2023 nga ora 08:00 deri në orën 12:00, ose sipas rastit deri në përfundimin e programit.

Lidhur me këtë pikë? Kalojmë në votimin e pikës 3.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka

***Me 5 vota pro, miratohet!***

Pika 4. Partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në KQV, duhet t'i depozitojnë kandidaturat në KZAZ-në përkatëse jo më vonë se data 13 korrik 2023. KZAZ-ja merr vendim për anëtar të KQV-ve brenda 48 orëve nga data e dorëzimit të propozimeve.

Padyshim të gjitha këto janë afate të rëndësishme, por afatet e parashikuara në pikën 4 dhe në atë pasardhëse besoj që janë më të rëndësishmet lidhur me partitë politike apo subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje.

***Kush është dakord me pikën 4?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka

***Me 5 vota pro, miratohet!***

Pika 5. Partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në GNV, duhet t'i depozitojnë kandidaturat në KZAZ, jo më vonë se data 17 korrik 2023. KZAZ-ja merr vendim për emërimin e anëtarëve të GNV-ve brenda 48 orëve, nga data e dorëzimit të propozimeve.

Kolegë, edhe për këtë afat të rëndësishëm kemi diçka për paraqitjen e kandidaturave dhe miratimin për GNV-të dhe miratimin e tyre nga KZAZ-të? Kalojmë në votimin e pikës 5.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.06.07.2023*

***Me 5 vota pro, miratohet!***

Pika 6. Paraqitja e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve shqiptarë, bëhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se data 17 korrik 2023, dhe për vëzhguesit e huaj bëhet jo më vonë se data 17 korrik 2023. Akreditimi i vëzhguesve bëhet nga KQZ-ja jo më vonë se data 21 korrik 2023.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

***Me 5 vota pro, miratohet!***

Pika 7. Paraqitja e kërkesave për akreditim nga ana e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje bëhet në KZAZ, jo më vonë se data 18 korrik 2023. Akreditimi i vëzhguesve, bëhet jo më vonë se data 20 korrik 2023.

Pra për të bërë dallimin ndërmjet vëzhguesve nga ana e subjekteve zgjedhore dhe vëzhguesve të tjerë. Një pjesë janë në KQZ të tjerët në KZAZ, kanë edhe afate të ndryshme. Për pikën 7! Kemi diçka kolegë? Jo, kalojmë në votimin e pikës 7.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

***Miratohet me 5 vota pro!***

Pika 8. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë tre ditëve të fundit, para datës së zgjedhjeve përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit.

Lidhur me afatet për sondazhet? Nuk ka, kalojmë në votimin e pikës 8.

***Kush është dakord?***


***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

***Miratohet me 5 vota pro!***

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.06.07.2023*

Pika 9. Monitoruesit e fushatës zgjedhore të angazhohen nga data 10 korrik deri në datën 23 korrik 2023.

Para se të kalojmë në votimin e kësaj pike unë kam një pyetje. Kur themi deri në datën 23 korrik duket sikur nuk përfshihet data 23 korrik, në fakt monitoruesit kanë detyrime për monitorim edhe ditën e zgjedhjeve. Kështu që unë do të kërkoja një riformulim lidhur me këtë pikë. “..të angazhohen nga data 10 korrik deri në datën 23 korrik me përfundimin e afatit.., pra gjatë zbardhjes ju lutem.., të procesit të votimit, merrni këtë parasysh gjatë zbardhjes. Kolegë ta kalojmë në votim propozimin?

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S’ka

***Miratohet me 5 vota pro!***

Pika 10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S’ka

***Miratohet me 5 vota pro!***

Pika 11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)


***Kundër:*** S’ka

***Miratohet me 5 vota pro!***

Atëherë kemi edhe formatin e zakonshëm “ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi”, para publikimit edhe hyrjes në fuqi.

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.06.07.2023*

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S'ka

***Me 5 vota pro, miratohet!***

Do t'i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm që menjëhere me zbardhjen e vendimit të publikohet menjëherë në faqe dhe t'u njoftohet subjekteve zgjedhore për të pasur parasysh këto afate që sapo miratuam. Minimalisht pas disa ditësh fillon fushata zgjedhore dhe referuar këtij vendimi që sapo miratuam edhe raportimet e veprimtarive publike, nëse do të ketë veprimtari për datën 10, duhet të raportohen që nesër në datën 7, pra 3 ditë para. Kështu që është emergjente publikimi dhe njoftimi i vendimit.

**Vendim nr. 25**

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*





**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y. Merkaj

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

*Znj. I. Nano:* Atëherë kalojmë edhe në projektvendimin tjetër, zoti Merkaj shkurtimisht lidhur me këtë ndryshim të propozuar.

*Z. Y. Merkaj:* Faleminderit! Referuar nenit 20, pika 1, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, kemi paraqitur projektaktin “Për një ndryshim në

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.06.07.2023*

vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores së KAS-it”. Projektakti përmban një ndryshim në vendimin nr. 3. Ky ndryshim vjen si nevojë për të detajuar të drejtën e ankimimit në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt ankimi. Në vendimin nr. 1, të datës 22.1.2022, i Komisionit Rregullator, është bërë një shtesë në rregulloren e KAS-it dhe konkretisht në fund të pikës 8, të nenit 9, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, ka parashikuar se: “...për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme, afati i ankimimit 3 ditë, i përcaktuar në pikat 1, 7 dhe 8, të këtij neni, bëhet 24 (njëzetë e katër) orë...”. në të njejtën linjë kemi parashikuar dhe propozuar që të shtohet përveç zgjedhjeve të parakohshme dhe të pjesshme, edhe zgjedhjet e përsëritura, në rastin e zgjedhjeve të përsëritura.

Bashkelidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Merkaj, sikundër ju e theksuat, në zgjedhjet e pjesshme të vitit kaluar në 6 bashki, ne e kemi bërë këtë ndryshim për shkak se Kodi Zgjedhor parashikon afate më të gjata. Pra kemi parashikuar zgjedhjet e parakohëshme dhe/ose të pjesshme, por rasti i përsëritjes së zgjedhjeve mbeti me të njejtat afate të rregullta që ishin tre ditore. Kështu që është propozuar 24 orë. Kolegë në parim lidhur me projektvendimin? Nuk ka diçka, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin numër 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të ndryshuar”.


**Kush është dakord në parim?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S’ka

**Me 5 vota pro, miratohet!**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



Kalojmë nen për nen, apo pikë për pikë.

Pika 1. Fjalja e fundit e pikës 8 të nenit 9 të Rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, miratuar me vendimin numër 3, datë 06.11.2020 i Komisionit Rregullator i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme, apo në rastin e përsëritjes së zgjedhjeve, afati i ankimimit 3 ditë i përcaktuar në pikat 1, 7 dhe 8 të këtij neni bëhet 24 orë”.

Kolegë kemi diçka me pikën 1? Jo, kalojmë në votimin e pikës 1.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S’ka***

***Miratohet me 5 vota pro!***

Pika 2. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S’ka***

***Me 5 vota pro, miratohet!***

Pika 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***


***Kundër: S’ka***

***Me 5 vota pro, miratohet!***

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

**Miratohet me 5 vota pro!**

**Z. M. Çakaj:** Më falni, në pikën 2 të këtij vendimi për saktësim kur të zbardhet, përveç administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të ngarkohet dhe KAS-i, sepse prek drejtpërdrejtë dhe veprimtarinë e KAS-it. Kështu që ta ketë në konsideratë administrata e KQZ-së kur të zbardhë vendimin, që në zbardhje, ose mund ta propozojmë edhe si shtesë. Ngarkohet KAS dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

**Znj. I. Nano:** Në rregull, e votojmë propozimin e zotit Çakaj.

**Kush është dakord me këtë ndryshim në pikën 2?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

**Miratohet me 5 vota pro!**

Kalojmë me votimin në tërësi të projektvendimit dhe njëherë kolegë dakordësinë tuaj.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

**Me 5 vota pro, miratohet!**

Për procedurë, nuk pyeta në fillim të mbledhjes, po pyes në fund. Mbasi shqyrtuam të dy pikat që kishim në rendin e ditës, nëse ndonjë nga kolegët ka diçka në çështjet jashtë rendit të ditës për të shqyrtuar? Nuk ka!

Atëherë mbledhjen e deklarojmë të mbyllur, faleminderit!

**Vendim nr. 26**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

